

# Korrupsioni në Shqipëri

Perceptime dhe Përvoja

**SONDAZHI 2008**

Përmbledhje e rezultateve

Përgatitur nga IDRA, Shqipëri

**DPK**  
consulting



## Përmbajtja

	Page
1. Hyrje.....	3
2. Struktura dhe demografia e kampionit.....	4
2.1 Kampioni i publikut të gjerë.....	4
2.2 Kampioni i sektorit publik.....	5
3. Toleranca e gabimit.....	6
4. Paraqitja e rezultateve.....	6
5. Perceptimi i korrupsionit.....	7
6. Përvoja me korrupsionin.....	12
7. Kontributi i institucioneve në luftën kundër korrupsionit.....	14
8. Transparenca.....	15
9. Besimi tek institucionet.....	17
10. Sistemi gjyqësor.....	20
11. Sjelljet ndaj korrupsionit.....	23
12. Problemet me të cilat përballlet Shqipëria.....	25

## 1. Hyrje

Ky raport paraqet rezultatet e sondazhit mes publikut të gjerë dhe punonjësve të sektorit publik mbi çështjet e korrupsionit, të kryer në vitin 2008. Raporti është i katërti i këtij lloji dhe pason raportet e sondazheve të kryera në vitet 2004, 2005 dhe 2006. Objektivi kryesor i këtyre sondazheve është të masë në mënyrë periodike perceptimin e publikut, përvojat dhe sjelljen e tij kundrejt korrupsionit në Shqipëri.

Grupi i sondazheve përbëhet nga:

- **Kampioni<sup>1</sup> i Publikut të gjerë**
  - o **Objektivi** - Kampion kombëtar prej 1200 të intervistuarish, mbi 18 vjeç
  - o **Realizimi** – 1,176 të intervistuar

**Shënim 1:** Sondazhi 2008 u realizua gjatë muajve janar dhe shkurt 2008. Sondazhet 2005 dhe 2006 u realizuan si më poshtë: i) sondazhi 2005: nëntor - dhjetor 2005, ii) sondazhi 2006: nëntor - dhjetor 2006. Si rrjedhim, diferenca në kohë ndërmjet sondazhit 2008 dhe atij 2006 nuk është dy vjet, por vetëm 14 muaj.

**Shënim 2:** Ky sondazh është kryer përpara shpërthimit të datës 15 mars 2008, në Gërdec. Çfarëdolloj ndikimi, që debati politik dhe trajtimi nga media i kësaj ngjarjeje, mund të kenë pasur mbi opinionin publik, nuk reflektohet në rezultatet e këtij sondazhi.

*1 - Kampion/mostër/gjedhe – është një term që përdoret në shkencën e sondazheve për të emërtuar grupin e njerëzve të përzgjedhur për t'u intervistuar. Kampioni, nga vetë përkufizimi duhet të jetë përfaqësues i popullsisë nga e cila përzgjidhet.*




Sondazhi u mundësua nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ai u përgatit nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA) në kuadër të Projektit të Shtetit Ligjor të USAID. Pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

## 2. Struktura dhe demografia e kampionit


### 2.1. Kampioni i publikut të gjerë

Kampioni i publikut të gjerë u përzgjedh bazuar në një proces seleksionimi me disa faza, mbi bazën e listës së qendrave të votimit të zgjedhjeve të fundit vendore. Për qëllime të kampionimit, qendrat e votimit përfaqësojnë njësinë bazë të kampionimit. 100 njësitë bazë të kampi-


onimit u përzgjedhën nga një formulë me një numër të rastësishëm, e cila merr parasysh numrin e votuesve në secilën qendër votimi si edhe shpërndarjen e tyre në zona rurale dhe urbane. Brenda zonës gjeografike të përcaktuar nga këto njësi, i intervistuari u përzgjedh me metodën e rrugës rastësore (një në çdo tri dyer, dhe intervistimi i personit me ditëlindjen më të fundit në familjen e përzgjedhur).



**Fig. 1** Gjinia e të intervistuarve  
*Publiku i gjerë 2008*



**Fig. 2** Të intervistuar në zona urbane dhe rurale  
*Publiku i gjerë 2008*



## 2.2. Kampioni i sektorit publik

Për kampionin e sektorit publik u përdor metoda me kuota, bazuar në katër kategori kryesore, duke synuar 150 të intervistuar në secilën prej tyre.

Kategoritë e kampionit janë:

### 1. Administrata qendrore

- Të gjitha ministritë e linjës
- Të gjitha institucionet qendrore përveç ministrive të linjës
- Sistemi fiskal (doganat dhe tatimet)
- Institucione buxhetore të pavaruara

### 2. Administrata vendore

- Komunat
- Bashkitë

### 3. Sistemi arsimor

- Kampion gjeografikisht i shpërndarë në:
  - Arsimin parashkollor (kopshte)
  - Arsimin e detyrueshëm (shkolla 9-vjeçare)
  - Shkollat e mesme
  - Universitete

### 4. Sistemi shëndetësor

- Kampion gjeografikisht i shpërndarë i:
  - Mjekëve
  - Infermierëve
  - Dentistëve dhe farmacistëve (shërbimi publik)

Tab. 1 Shpërndarja e kampionit përfundimtar sipas kategorive të sektorit publik

Kategoritë	Nr. i të intervistuarve	Përqindje
Administrata qendrore	134	23.6
Administrata vendore	138	24.3
Sistemi arsimor	149	26.2
Sistemi shëndetësor	147	25.9
Gjithsej	568	100

Tab. 2 Gjinia e të intervistuarve sipas kategorive

Kategoria /Gjinia		Mashkull	Femër	Gjithsej
Administrata qendrore	Nr.	57	77	134
	%	42.5	57.5	100
Administrata vendore	Nr.	70	68	138
	%	50.7	49.3	100
Sistemi arsimor	Nr.	29	120	149
	%	19.5	80.5	100
Sistemi shëndetësor	Nr.	31	116	147
	%	21.1	78.9	100
Gjithsej	Nr.	187	381	568
	%	32.9	67.1	100

### 3. Toleranca e gabimit

Toleranca e gabimit për kampionin e publikut të gjerë është  $\pm 2,8\%$  dhe për kampionin e sektorit publik është  $\pm 4\%$ , të dy me një interval besueshmërie prej 95%. Teknikisht, një tolerancë gabimi  $\pm 2,8\%$  nënkupton që, nëse merren në mënyrë të përsëritur kampione të kësaj madhësie, 95% e tyre do të pasqyrojnë opinionet e popullatës me pasaktësi jo më të madhe se  $\pm 2,8\%$ . Kontrolli i rëndësishëm statistikor, i cili mban parasysh tolerancën e gabimit, është i rëndësishëm veçanërisht kur krahasohen të dhëna historike ose kur paraqitet analiza e rezultateve për nëngrupe. Këto kontrolle statistikore janë zbatuar në rezultatet e paraqitura në këtë raport.

### 4. Paraqitja e rezultateve

Shumica e rezultateve të sondazhit paraqiten në shkallën 0-100. Për t'u kuptuar më mirë dhe për arsye të paraqitjes, shkallët e ndryshme të përdorura në pyetësor janë kthyer në shkallën 0-100.


Më poshtë jepet një shembull i kthimit të shkallës përmes një pyetjeje të pyetësorit:

*[Përdor kartën "D"] Tani unë do të përmend disa institucione publike dhe private. Jam i interesuar të di mendimin tuaj sesa të korrumpuar apo të ndershëm janë përfaqësuesit e këtyre institucioneve. Ju lutem, vlerësoni secilin prej tyre me numrat nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë "Shumë i ndershëm" dhe 10 "Shumë i korrumpuar".*

INSTITUCIONI	Nivelet e korrupsionit										Nuk e di/Pa përgjigje	PC19
	Shumë i ndershëm					Shumë i korrumpuar						
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(88)	
PC19. Mësuesit e shkollave publike												

Konvertimi bëhet duke zbritur 1 nga secili numër i shkallës 1-10, kështu që pyetjet renditen në një shkallë 0-9. Më pas, kjo shkallë pjesëtohet me 9 duke përfutur një shkallëzim 0-1, i cili është shumëzuar me 100 për të arritur në shkallën 0-100. Sipas kësaj shkalle del: 0=shumë i ndershëm dhe 100=shumë i korrumpuar. Një grafik ilustrues paraqitet në të djathtë.

Në këtë grafik shembull, kategoria "mësues" merr vlerësimin "48". Ky vlerësim nuk nënkupton që 48% e publikut mendon se mësuesit janë të korrumpuar; ai përfaqëson perceptimin sesa i korrumpuar është një institucion në një shkallë 0 - 100. Vlerësimi prej 48 pikësh do të thotë se ky grup klasifikohet në mes të shkallës së korrupsionit, sipas perceptimit të publikut.



### Përmbledhje e rezultateve


## 5. Perceptimi i korrupsionit

Renditja e institucioneve/grupeve bazuar në perceptimin e korrupsionit në sondazhin e publikut të gjerë 2008 është e ngjashme me atë të sondazheve 2006 dhe 2005. Pjesa më e madhe e institucioneve vazhdojnë të shihen si të korruptuara, me më shumë se 50 pikë në shkallën 0 - 100, ku 0 është "Shumë i ndershtëm" dhe 100 është "Shumë i korruptuar".


Drejtuesit fetarë, ushtarakët, media, presidenti, mësuesit dhe drejtuesit e OJF-ve shihen si më të ndershtmit midis grupeve të ndyshme të renditura. Të gjitha këto institucione/grupe kanë marrë më pak se 50 pikë në shkallën e korrupsionit. Doganierët, mjekët, tatimorët dhe ministrat shihen si më të korruptuarit. (Fig.3).

Korrupsioni në institucionet e analizuar perceptohet i lartë madje edhe nga punonjësit e sektorit publik. Sidoqoftë, vlerësimi i tyre është mesatarisht pak më i ulët, krahasuar me publikun e gjerë (Fig.4). Media dhe drejtuesit e OJF-ve janë vlerësuar më negativisht nga punonjësit publikë sesa nga publiku i gjerë. Ata i japin medias 41 pikë, 6 pikë më shumë se publiku i gjerë, duke i parë gjithsesi mediat si më shumë të ndershme sesa të korruptuara. Në mënyrë të ngjashme, drejtuesit e OJF-ve vlerësohen nga punonjësit publikë me 6 pikë më shumë (48,3 pikë) krahasuar me publikun e gjerë (42,8 pikë). Policët, kryetarët e bashkive, ministrat, prefektët, presidenti, deputetët dhe mjekët vlerësohen më pozitivisht nga punonjësit e sektorit publik. Sidoqoftë, të gjitha këto institucione vlerësohen me më shumë se 50 pikë, gjë që tregon se ato shihen si më shumë të korruptuara sesa të ndershme.

**Fig. 3 Ndershmëria kundrejt Korrupsionit**  
Publiku i gjerë 2008



**Fig. 4 Ndershmëria kundrejt Korrupsionit**  
Publiku i gjerë kundrejt Sektorit publik 2008



Shumica e institucioneve nuk paraqesin ndryshim në perceptimin e publikut për korrupsionin krahasuar me 2006. Fig.5 tregon vetëm ato institucione për të cilat perceptimi i korrupsionit ndryshon nga viti 2005 në 2008.

Ndërsa presidenti vazhdon të konsiderohet i ndershëm nga qytetarët, (36,7 pikë në shkallën 0-100), rezultati për 2008 tregon një përkeqësim prej 15 pikësh nga viti 2006 dhe 8 pikë më shumë nga viti 2005.


Perceptimi për median tregon një përmirësim prej 6 pikësh krahasuar me 2006 (nga 42 pikë në vitin 2006 në 35,5 pikë në 2008). Media pra shihet si më e ndershme krahasuar me sondazhin e mëparshëm.

Perceptimi për ministrat dhe deputetët është përkeqësuar krahasuar me sondazhin e vitit 2006. Ministrat janë vlerësuar me pothuajse 78 pikë në këtë shkallë, 7 pikë më shumë sesa në sondazhin 2006. Deputetët janë vlerësuar me 78 pikë, 5 pikë më shumë se në 2006.

Ndërkohë që shihen si grupi më i korruptuar ndër zyrtarët publikë, vlerësimi për tatimorët ka megjithatë një përmirësim të lehtë nga sondazhi i vitit 2005 (nga 83,1 pikë në 2005 në 78,4 pikë në 2008).

**Fig. 5 Ndershmëria kundrejt Korrupsionit**

*Krahasim në vite (vetëm ato institucione që shfaqin ndryshime)*





Qytetarët besojnë se korrupsioni është ende një fenomen i përhapur ndërmjet zyrtarëve publikë. Pothuajse 92% e të intervistuarve në sondazhin 2008 thanë se korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë është “Shumë i përhapur” ose “Deri diku i përhapur” (Fig.6). Më shumë se gjysma e të intervistuarve (57,1%) mendojnë se korrupsioni midis zyrtarëve publikë është, në fakt, shumë i përhapur. Ky perceptim nuk ka ndryshuar që nga 2005 (95,3% në 2005 dhe 94% në 2006).

Në mënyrë interesante vetë punonjësit e sektorit publik mendojnë se korrupsioni është një fenomen i zakonshëm midis tyre. Afërsisht 83% e kampionit të punonjësve publikë thanë se ky është një fenomen “Shumë i përhapur” ose “Deri diku i përhapur”. Ky opinion mbetet i njëjtë me atë të 2006 (Fig.7).

Në përgjigje të pyetjes “Sa e përhapur është praktika e ryshfeteve midis zyrtarëve publikë?” 44,8% e të intervistuarve në sektorin publik thanë se kjo praktikë është “Shumë e përhapur”, 44,1% thanë se është “Disi e përhapur” dhe vetëm 11,2% thanë se është “E papërfillshme” ose “Nuk ekziston”.

Fig. 6 Opinions për korrupsionin ndërmjet zyrtarëve publikë  
Publiku i gjerë





Fig. 7 Opinions për korrupsionin ndërmjet zyrtarëve publikë  
Sektori publik




Vetëm 13,3% e publikut të gjerë mendojnë se korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë është pakësuar gjatë vitit të kaluar (Fig.8). Pothuajse gjysma e të intervistuarve mendojnë se korrupsioni në fakt është rritur (47,2%), shifër kjo 13% më e lartë se në sondazhin 2006.


Opinionet e punonjësve të sektorit publik mbi prirjen e korrupsionit nga viti i kaluar janë më pozitive se ato të publikut të gjerë. Në kampionin e 2008, vetëm 21,6% e tyre thanë se korrupsioni është rritur. Sidoqoftë, duhet përmendur se 52,4% e tyre thanë se korrupsioni ka mbetur në të njëjtat nivele si vitin e kaluar.

Perceptimet e nëpunësve publikë ndryshojnë në varësi të sektorëve ku ata punojnë (Fig.9). Për shembull, vetëm 12% e atyre që punojnë në sektorin e arsimit dhe 19% atyre që punojnë në atë të shëndetësisë thanë se korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë është pakësuar krahasuar me një vit më parë. Kjo shifër është 40% për ata që punojnë në strukturat e administratës qendrore dhe 36% për ata që punojnë në strukturat e administratës vendore.

**Fig. 8** Korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë krahasuar me vitin e kaluar  
*Publiku i gjerë*




**Fig. 9** Korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë krahasuar me vitin e kaluar - sipas sektorëve  
*Sektori publik 2008*




Perceptimi i korrupsionit duket të jetë shumë i lidhur me prirjet politike<sup>2</sup> të të intervistuarve. Ndërkohë që 61% e të intervistuarve me prirje të majta thonë se korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë është rritur gjatë vitit të fundit, vetëm 38,5% e të intervistuarve me prirje të djathta mendojnë të njëjtën gjë. Në të njëjtën linjë, vetëm 6,3% e të intervistuarve me prirje të majta mendojnë se korrupsioni është ulur krahasuar me 27,4% të të intervistuarve me prirje të djathta që mendojnë të njëjtën gjë.

Në sondazhin 2008, të intervistuarit “me prirje politike të djathta” që mendojnë se korrupsioni është “rritur” gjatë vitit të fundit janë 20% më shumë krahasuar me sondazhin e 2006 (Fig.11).

**Fig. 10** Korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë krahasuar me vitin e kaluar - sipas prirjeve politike  
*Publiku gjerë 2008*



**Fig. 11** Korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë krahasuar me vitin e kaluar - prirje të djathta  
*Publiku i gjerë*



2 - Të intervistuarit u pyetën të përcaktojnë prirjet e tyre politike në një shkallë 1-10, ku 1 është shumë i majtë dhe 10 është shumë i djathtë. Të intervistuarit me prirje të majta janë përcaktuar ata që dhanë përgjigje 1-4, në qendër janë ata me përgjigje 5-6, ndërsa me prirje të djathta janë ata që dhanë përgjigje 7-10.

## 6. Përvoja me korrupsionin

Përpos pyetjeve të lidhura me perceptimin, në këtë vërtim është përfshirë edhe një grup pyetjesh të lidhura me përvojën përsa u përket transaksioneve korruptive. Të intervistuarit pyeten nëse kanë **dhënë rryshfete** për institucione dhe zyrtarë të ndryshëm apo nëse **u është kërkuar** nga nëpunësit publikë të paguajnë rryshfet. Qëllimi i kësaj të fundit është të masë presionin që nëpunësit publikë mund të ushtrojnë për të kërkuar rryshfete.

“Dhënia e rryshfetit për marrjen e trajtimit mjekësor” është raportuar nga 69% e të intervistuarve që u janë drejtuar spitaleve dhe klinikave publike gjatë vitit të fundit (58% e të intervistuarve deklaruan që kanë vizituar spitalet/

klinikat publike). Ky rezultat konfirmon se sektori i shëndetësisë mbetet një nga sektorët më të korruptuar në vend pa ndonjë përparim të bërë gjatë viteve të fundit.

Vetëm 10% e të intervistuarve thonë se u është kërkuar nga policët të paguajnë rryshfet. Megjithatë 27,3% thonë se kanë parë dikë t’i japë rryshfet një polici.

11% e të intervistuarve thonë se u është kërkuar të paguajnë një rryshfet nga një zyrtar publik gjatë vitit të kaluar, ndërsa gati 15% deklarojnë që kanë parë dikë t’i japë një rryshfet një zyrtari publik.

Tab. 3 Eksperienca me korrupsionin

	Përvoja me korrupsionin – Publiku i gjerë 2008	në %	Po	Jo	Nr. i përgjigjeve
1	A ju ka kërkuar ndonjë polic të paguanit rryshfet gjatë vitit të kaluar?		10.4	89.6	1174
2	Gjatë vitit të kaluar, a keni parë ndonjë person t’i japë rryshfet ndonjë polici?		27.3	72.7	1172
3	Gjatë vitit të kaluar, a keni parë ndonjë person t’i japë rryshfet një zyrtari publik?		14.7	85.3	1167
4	Gjatë vitit të kaluar, a ju ka kërkuar ndonjë zyrtar publik t’i jepni rryshfet?		10.8	89.2	1171
5	Gjatë vitit të kaluar, a ju është dashur të paguani rryshfet për të nxjerrë ndonjë lloj dokumenti (certifikata, leje biznesi, etj)?		25.7	74.3	1166
6	A ju është dashur që të paguani rryshfet në Prokurori gjatë vitit të kaluar?		10.2	89.8	157 *
7	A ju është dashur që të paguani rryshfete në gjykata gjatë vitit të kaluar?		36.1	63.9	97 **
8	A njihni personalisht ndonjë njeri të cilit i është kërkuar nga një gjyqtar/punonjës gjykate të paguajë rryshfet?		16.4	83.6	1156
9	A ju është dashur që të paguani rryshfet për të marrë trajtim mjekësor?		69.0	31.0	688 ***
10	A ju është kërkuar rryshfet për të shmangur apo ulur pagesën e dritave, telefonit apo ujit?		7.7	92.3	1146

\* - Vetëm ata që kanë pasur të bëjnë me Prokurorinë

\*\* - Bazë e vogël. Vetëm ata që kanë pasur të bëjnë me gjykatat

\*\*\* - Vetëm ata që kanë pasur të bëjnë me spitalet/klinikat publike

Vetëm 8% e të intervistuarve (97 të intervistuar) thanë që kanë pasur të bëjnë me gjykatat gjatë vitit të kaluar. Nga këta 1 në 3 persona deklarojnë se u është dashur të paguajnë ryshfet.

Nga personat që kanë pasur të bëjnë me prokurorinë gjatë vitit të kaluar (157 të intervistuar), 1 në 10 deklarojnë që u është dashur të paguajnë ryshfet.

Krahasimi i rezultateve të 2008 me ato të viteve të mëparshme, tregon se shumica e pyetjeve të lidhura me përvojën kanë marrë përgjigje të njëjta ashtu sikurse

paraqitet në Tabelën 5, duke treguar se nuk ka përparim për këta tregues. Në dy fusha rezultatet tregojnë përkeqësim:

- “Ryshfetet e dhëna për të nxjerrë dokumente zyrtare”, në 2008 është përmendur nga 25,7% e të intervistuarve, 6% më shumë se në 2006.
- “Ryshfet për të marrë trajtim mjekësor” në 2008 është raportuar nga 7% më shumë të intervistuar se në 2006.

Tab. 4 Tendencat e përvojës së korrupsionit

	Përvoja me korrupsionin – Publiku i gjerë 2005-2008 Vetëm ata që kanë thënë “Po” në %	Po 2005	Nr. i përgji- gieve	Po 2006	Nr. i përgji- gieve	Po 2008	Nr. i përgji- gieve	Tendencat e testuar statistikisht
1	A ju ka kërkuar ndonjë polic të paguanit ryshfet gjatë vitit të kaluar?	12.3	1199	9.0	1197	10.4	1174	Nuk ka ndryshim
2	Gjatë vitit të kaluar, a keni parë ndonjë person t'i japë ryshfet ndonjë polici?	33.2	1198	23.2	1194	27.3	1172	Nuk ka ndryshim nga 2006 Më mirë nga 2005
3	Gjatë vitit të kaluar, a keni parë ndonjë person t'i japë ryshfet një zyrtari publik?	18.7	1195	13.0	1195	14.7	1167	Nuk ka ndryshim
4	Gjatë vitit të kaluar, a ju ka kërkuar ndonjë zyrtar publik t'i jepni ryshfet?	12.2	1195	8.5	1196	10.8	1171	Nuk ka ndryshim
5	Gjatë vitit të kaluar, a ju është dashur të paguani ryshfet për të nxjerrë ndonjë lloj dokumenti (certifikata, leje biznesi, etj)?	29.6	1188	19.4	1193	25.7	1166	Më keq nga 2006
6	A ju është dashur që të paguani ryshfet në Prokurori gjatë vitit të kaluar?	N/A		N/A		10.2	157	N/A
7	A ju është dashur që të paguani ryshfete në gjykata gjatë vitit të kaluar?	39.3	89	32.3	96	36.1	97	Nuk ka ndryshim
8	A njihni personalisht ndonjë njeri të cilit i është kërkuar nga një gjyqtar/punonjës gjykatë të paguajë ryshfet?	21.7	1191	14.7	1180	16.4	1156	Nuk ka ndryshim nga 2006 Më mirë nga 2005
9	A ju është dashur që të paguani ryshfet për të marrë trajtim mjekësor?	72.7	660	62.3	640	69.0	688	Më keq nga 2006
10	A ju është kërkuar ryshfet për të shmangur apo ulur pagesën e dritave, telefonit apo ujtit?	7.7	1163	6.7	1168	7.7	1146	Nuk ka ndryshim

3 - Kjo pyetje nuk ishte pjesë e sondazheve të 2005 dhe 2006. U shtua vetëm në sondazhin e 2008.


## Përmbledhje e rezultateve

## 7. Kontributi i institucioneve në luftën kundër korrupsionit


Perceptimi publik për kontributin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit ka ndryshuar shumë pak nga 2006. Media vazhdon të shihet si luftëtarja më e madhe duke mbajtur vendin e parë (63,3 pikë në një shkallë nga 0 tek 100, ku 0 është “Nuk ndihmon aspak” dhe 100 është “Ndhmon shumë”), me një diferencë të konsiderueshme nga të tjerët (Fig.12). Të gjitha institucionet e tjera vlerësohen me më pak se 50 pikë në shkallën e vlerësimit, që do të thotë se përgjithësisht shihen nga publiku si institucione që nuk ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit. Shoqëria civile mban vendin e dytë në largësi me 48,4 pikë. Me 36,1 pikë, ILKDP (Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive) vlerësohet se jep më pak ndihmesë në luftën kundër korrupsionit.

Nëse krahasojmë rezultatet e sondazhit të 2008 me ato të 2005 përsa u përket gjykatave dhe Prokurorisë së Përgjithshme, ka një përmirësim të lehtë. Gjykatat vlerësohen me 42 pikë në 2008, 6 pikë më shumë se në 2005, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme vlerësohet me 40,5 pikë, katër pikë më shumë se në 2005 (Fig.13). Institucionet e tjera nuk tregojnë ndryshim në perceptimin e publikut ndër vite.

**Fig. 12** Në ç'masë institucionet ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit?  
*Publiku i gjerë 2008*



**Fig. 13** Në ç'masë institucionet ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit?  
*Krahasim në vite*



## 8. Transparenca

Transparenca, sipas perceptimeve të publikut, mbetet një çështje kritike për institucionet në Shqipëri. Të gjitha institucionet e analizuar shënojnë më pak se 50 pikë në një shkallë nga 0 në 100, ku 0 është “Aspak transparent” dhe 100 është “Shumë transparent” (Fig.14). Ky është një tregues **perceptimi** dhe jo **përvojë**, por tregon se imazhi publik i këtyre institucioneve përsa i përket transparencës është shumë i ulët. Policia vazhdon të vlerësohet më mirë me 46,9 pikë dhe Agjencia për Kthimin dhe Kompenhimin e Pronave (AKKP) ka vlerësimin më të ulët me 27,3 pikë.

Edhe vetë punonjësit e sektorit publik mendojnë se transparenca është një problem në institucionet e analizuar. Megjithatë vlerësimi i tyre është më pozitiv sesa ai i publikut të gjerë, vetëm tre institucione (policia, pushteti vendor dhe qeveria) mezi e kanë kaluar pikën e mesit të shkallëzimit nga 0 në 100 (Fig.15). Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) ka marrë të njëjtin vlerësim të ulët nga punonjësit e sektorit publik si ai nga publiku i gjerë (27 pikë).

Fig. 14 Transparenca e institucioneve  
Publiku i gjerë 2008






Fig. 15 Transparenca e institucioneve  
Publiku i gjerë kundrejt Sektorit publik 2008




Në terma krahasimore, Qeveria dhe Parlamenti tregojnë një përkeqësim të perceptimit publik përsa i përket transparencës nga viti 2005 në 2008 (Fig.16). Nga 45 pikë në 2005, Qeveria ka rënë në 39 pikë në 2008. Gjithashtu edhe Parlamenti ka rënë me 6 pikë, nga 41 pikë në 2005 në 35 pikë në vitin 2008.

Perceptimet mbi transparencën e institucioneve nuk tregojnë ndonjë përmirësim edhe ndërmjet punonjësve të sektorit publik (Fig. 17). Me përjashtim të Pushtetit Vendor që tregon një përmirësim nga 2006 tek 2008 (nga 49 pikë në 56 pikë) asnjë institucion tjetër nuk tregon ndryshime statistishtë domethënëse.

**Fig. 16** Transparenca e institucioneve  
Krahasim në vite - Publiku i gjerë



**Fig. 17** Transparenca e institucioneve  
Krahasim në vite – Sektori publik






## 9. Besimi tek Institucionet

Besimi i qytetarëve tek institucionet vazhdon të mbetet i ulët. Me përjashtim të ushtrisë, drejtuesve fetarë dhe policisë, të gjitha institucionet e tjera janë vlerësuar me më pak se 50 pikë në shkallën nga 0 në 100, ku 0 është “Aspak besim” dhe 100 është “Shumë besim” (Fig.18). Qeveria (40 pikë), Parlamenti (39,5 pikë), Sindikatat (36,9 pikë), Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (32,1 pikë), dhe Partitë politike (31,9 pikë) janë më pak të besuarat ndër institucionet e vlerësuara..


Besimi tek institucionet, mesatarisht, është pak më i lartë ndër punonjësit e sektorit publik, krahasuar me publikun e gjerë. (Fig.19). Qeveria vlerësohet me vetëm 50 pikë dhe Parlamenti me vetëm 49 pikë në shkallën nga 0 në 100. Policia, pushteti vendor, kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë besohen më shumë nga punonjësit publikë sesa nga publiku i gjerë. Të gjitha këtyre institucioneve u jepet një vlerësim më i lartë se mesi i shkallës së besimit.

Nivelet e besimit ndërmjet punonjësve publikë ndryshojnë sipas sektorëve ku ata punojnë. Të intervistuarit që punojnë për administratën qendrore shprehin më shumë besim tek Qeveria sesa të intervistuarit nga sektori i arsimit apo ai i shëndetësisë (63 pikë kundrejt 43 pikë). E njëjta gjë ndodh me të intervistuarit e administratës lokale, kur pyeten rreth besimit në pushtetin vendor. Ata i japin pushtetit vendor 75 pikë, kurse të intervistuarit e arsimit dhe sektorit të shëndetësisë e vlerësojnë vetëm me 50 pikë.

**Fig. 18 Besimi tek institucionet**  
Publiku i gjerë 2008



**Fig. 19 Besimi tek institucionet**  
Publiku i gjerë kundrejt Sektorit publik 2008



Nga vrojtimi i 2005 në atë të 2008, ka vetëm pak ndryshime në besimin e institucioneve të vlerësuara nga qytetarët (Fig.20). Të vetmet institucione që tregojnë një lloj përmirësimi që nga 2005 janë i) "Gjykatat" (nga 40 pikë në 2005 në 45 pikë në 2008) dhe ii) "Prokuroria e Përgjithshme" (nga 37 pikë në 2005 në 42 pikë në 2008). Të gjitha institucionet e tjera nuk tregojnë ndryshim në besimin e shprehur nga qytetarët.

Ka disa ndryshime ndërmjet popullsisë urbane dhe rurale në lidhje me besimin në institucione të caktuara (Fig.21). Banorët e zonave rurale kanë më shumë besim tek drejtuesit fetarë sesa banorët në zonat urbane (62 pikë kundrejt 50 pikëve në shkallën 0-100). Gjithashtu Qeveria besohet pak më shumë në zonat rurale sesa në zonat urbane (43 pikë kundrejt 38 pikëve në zonat urbane). Njerëzit në zonat rurale kanë më shumë besim tek kryetarët e komunave të tyre sesa banorët e zonave urbane kanë tek kryebashkiakët (52 pikë kundrejt 46 pikëve në shkallëzim).

Fig. 20 Besimi tek institucionet

Institucione të përzgjedhura






Fig. 21 Besimi tek institucionet

Publiku i gjerë 2008 (Urban kundrejt rural)




Prirjet politike kanë gjithashtu ndikim në nivelin e besimit të shprehur nga qytetarët (Fig.22 deri te Fig.24). Qytetarët me prirje të djathta i besojnë qeverisë (të drejtuar nga Partia Demokratike) më shumë sesa qytetarët me prirje të majta (57 pikë kundrejt 30 pikëve). E njëjta gjë mund të thuhet për parlamentin. Megjithëse për të dyja grupet e qytetarëve (me prirje të djathta dhe me prirje të majta) besimi tek partitë politike është vlerësuar me më pak se 50 pikë, ata me prirje të djathta anojnë të kenë më shumë besim tek partitë politike sesa të intervistuarit me prirje të majta (42 pikë kundrejt 30 pikëve).


**Fig. 22 Besimi tek Qeveria qendrore - sipas prirjeve politike**  
*Publiku i gjerë 2008*



**Fig. 23 Besimi tek Parlamenti - sipas prirjeve politike**  
*Publiku i Gjerë 2008*



**Fig. 24 Besimi tek Partitë politike - sipas prirjeve politike**  
*Publiku i gjerë 2008*




## 10. Sistemi gjyqësor


Sistemi gjyqësor është një nga shtyllat më të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit, megjithatë shumica e shqiptarëve (pothuajse 60% e të intervistuarve në sondazhin 2008) thonë se kanë pak ose aspak besim në këtë sistem (Fig.25). Gjithsesi, megjithëse një nivel i dobët besimi, tregon një përmirësim prej gjashtë përqind nga 2005.

Njerëzit që mendojnë se gjyqtarët nuk janë të paanshëm në drejtimin e proceseve gjyqësore, janë më shumë se trefishi i atyre që mendojnë se gjyqtarët janë të paanshëm (Fig.26). Kjo shifër nuk ka ndryshuar nga sondazhi i vitit 2006.

**Fig. 25 Besimi tek sistemi gjyqësor**  
*Publiku i gjerë*




**Fig. 26 Gjyqtarët janë të paanshëm në dhënien e drejtësisë**  
*Publiku i gjerë*




“Faktet dhe ligji i aplikueshëm” është faktori që ndikon më pak mbi rezultatin e gjyqeve sipas të intervistuarve (Fig.27). Në një shkallëzim nga 1 në 10 ku 1 është “Nuk ka ndikim” dhe 10 është “Ndikon shumë”, ky faktor shënon 5,8 pikë. Faktori më i rëndësishëm sipas të intervistuarve që ndikon në marrjen e vendimeve gjyqësore është “Ryshfeti/Pagesa e parave për të ndikuar vendimin” me 8,6 pikë e ndjekur nga “Lidhjet personale dhe lidhjet e biznesit” të gjyqtarëve me 7,5 pikë dhe 7,3 pikë respektivisht.

Vetë gjyqtarët janë të ndërgjegjshëm që ata nuk gëzojnë reputacion të lartë në publik. Të pyetur se si mendojnë ata se i percepton publiku, në një shkallë nga 0 në 100, ku 0 është “Shumë dobët” dhe 100 “Shumë mirë”, ata i japin 39,4 pikë imazhit të tyre. Sipas gjyqtarëve, publiku i gjerë nuk ka mendim të mirë as për avokatët, duke i vlerësuar ata me 34,1 pikë.

**Fig. 27 Faktorët që influencojnë në marrjen e vendimeve gjyqësore**  
Publiku i gjerë 2008



**Fig. 28 Vlerësimi se si gjyqtarët dhe avokatët shihen nga publiku**  
Sondazhi i gjyqtarëve 2008




Gati gjysma e gjyqtarëve të intervistuar mendojnë se korrupsioni në Shqipëri është një problem serioz.


Gjyqtarët gjithashtu përmendën se palët në gjyq dhe avokatët u bëjnë atyre oferta korruptive, që shpalos një dimension tjetër të korrupsionit aktiv nga ana tjetër e ekuacionit. Sipas përgjigjeve të tyre, ndonjëherë palët në proces gjyqësor nuk janë thjesht aktorë pasivë. Ata janë pjesëmarrës aktivë në përpjekjet për të korrumpuar gjyqtarët. 41% e gjyqtarëve të pyetur thanë që palët përpiqen t'i ndikojnë ata me oferta korruptive (Fig.29). Më shumë se 55% e tyre gjithashtu thanë se avokatët përpiqen t'i ndikojnë ata jashtë sallës së gjyqit për të influencuar vendimet e tyre.

Gjyqtarët kundërshtojnë opinionin që ata nuk janë të paanshëm në dhënien e drejtësisë. 75% e tyre thonë se ata janë të paanshëm në dhënien e drejtësisë dhe vetëm 8% mendojnë ndryshe (Fig.30).

**Fig. 29** Korrupsioni në gjykatat shqiptare dhe roli i avokatëve dhe palëve pjesëmarrëse në gjyq  
Sondazhi i gjyqtarëve 2008



**Fig. 30** Gjyqtarët janë të paanshëm në dhënien e drejtësisë  
Sondazhi i gjyqtarëve 2008




## 11. Sjelljet ndaj korrupsionit

Si edhe në sondazhet e mëparshme, sondazhi 2008 përfshinte pyetje që kërkonin opinionin e qytetarëve rreth palëve të përfshira në skenarë të ndryshëm të transaksioneve korruptive. Rezultatet tregojnë se shqiptarët “gjykojnë” ndryshe ata që “marrin” ryshfet prej atyre që e “japin” atë. Vihet re njëfarë tolerance në rastet e “dhënësve” të ryshfetit në transaksionet e korrupsionit. Kjo është veçanërisht e dukshme në skenarë të ndryshëm nga skenari klasik, ku një biznes i jep ryshfet një ministri për të fituar një tender (Fig.31).

Studenti që i jep mësuesit një këmishë si dhuratë me shpresën për të marrë një notë më të mirë shihet më shumë si “Jo i korruptuar” (29,9% e të intervistuarve) ose “I justifikuar” (41,9% e të intervistuarve). Gjithashtu, nëna e fëmijëve që për të marrë certifikatat e fëmijëve paguan 500 lekë si ryshfet për të mos qëndruar në radhë shihet kryesisht si “Jo e korruptuar” (21,4% e të intervistuarve) ose “E justifikuar” (56,1% e të intervistuarve).

Fig. 31 Sjelljet ndaj korrupsionit

Publiku i gjerë 2008




Ekziston ende njëfarë konfuzioni në publikun shqiptar përsa i përket kuptimit të qartë se çfarë përbën korrupsion. Të pyetur për “pronarin e një dyqani lulesh i cili rrit çmimin e luleve gjatë festave”, 52% e qytetarëve u përgjigjën se ky pronar është “I korruptuar dhe duhet të ndëshkuar” (Fig.32). Opinioni i punonjësve të sektorit publik për të njëjtin skenar është shumë i ngjashëm. 52,7% e të intervistuarve nga ky kampion thanë se pronari i dyqanit është i korruptuar dhe duhet ndëshkuar.

Dëshmi e konfuzionit të këtij “abuzimi” të perceptuar (biznese që vendosin çmime tejet të larta për produktet apo shërbimet e tyre) me fenomenin e korrupsionit, ndeshet edhe në përgjigjet e pyetjeve se çfarë i bën avokatët të korruptuar. 60% e të intervistuarve thanë se, nëse një avokat kërkon pagesë të lartë, ai/ajo është i korruptuar (Fig.33).

**Fig. 32** Pronari i një dyqani lulesh i cili rrit çmimin e luleve gjatë festave

Publiku i gjerë kundrejt Sektorit publik 2008



**Fig. 33** A mendoni se një avokat është i korruptuar kur kryen veprimet e mëposhtme

Publiku i gjerë 2008





## 12. Problemet me të cilat përballet Shqipëria

Një seksion i sondazhit i kushtojë marrjes së opinionëve në lidhje me problemet më kryesore me të cilat përballet Shqipëria.

Ekonomia është shqetësimi numër një i qytetarëve në sondazhin 2008. Papunësia, problemet ekonomike, varfëria dhe inflacioni së bashku, janë identifikuar nga 83,1% e të intervistuarve si problemet kryesore me të cilat përballet sot Shqipëria. Problemet të renditura për nga rëndësia e tyre sipas perceptimit të qytetarëve janë papunësia (32% e të intervistuarve), pasuar menjëherë nga problemet ekonomike (31,9% e të intervistuarve).

Gjatë periudhës që u realizua puna në terren për sondazhet 2005 dhe 2006, Shqipëria po kalonte një krizë energjetike me ndërprerje të përditshme të energjisë. Në ato kushte, energjia elektrike u cilësua problemi numër një në 2005 (35,6%) dhe problemi i dytë në 2006 (22,8%). Në muajt e parë të 2008, Shqipëria nuk ka pasur krizë energjetike, një faktor që mund të jetë shkaku për zbritjen e energjisë elektrike më poshtë në renditje, me vetëm 2,6% të të intervistuarve që e përmendin si problem.

Punonjësit e sektorit publik janë në një mendje me publikun e gjerë përsa i përket prioritetit të çështjeve ekonomike me 34,2 % prej tyre që përmendin problemet ekonomike si shqetësimin e parë, pasuar nga papunësia me pothuajse 20% të përgjigjeve (Fig.35).

Këtë vit është për t'u cilësuar se "Inflacioni/ Çmimet e larta" është përmendur si një nga problemet më të rëndësishme me të cilat po përballet Shqipëria. Pothuajse 8% e të intervistuarve në kampionin e publikut të gjerë dhe 11,1% e të intervistuarve në kampionin e sektorit publik e kanë konsideruar atë si një problem kryesor në vend (Fig.35).

## Përmbledhje e rezultateve

Fig. 34 Problemi më i vështirë me të cilin po përballet Shqipëria

Publiku i gjerë





Fig. 35 Problemi më i vështirë me të cilin po përballet Shqipëria

Publiku i gjerë kundrejt Sektorit publik 2008




Pjesa më e madhe e shqiptarëve në sondazhin 2008 (60,4%) e vlerësoi situatën e përgjithshme ekonomike të vendit si “E keqe ose shumë e keqe” (Fig.36). Ky numër është pothuajse 13% më i lartë se në sondazhin 2006 (47,8%). Të pyetur për krahasimin e situatës ekonomike me një vit më parë, 54% e të intervistuarve thanë se gjendja këtë vit është më e keqe (Fig.37). Kjo shifër është më shumë se dyfishi i asaj të sondazhit 2006, ku vetëm 24% e të intervistuarve mendonte se gjendja ekonomike ishte më e keqe se një vit më parë.

Vlerësimi i situatës së përgjithshme ekonomike nga punonjësit e sektorit publik nuk është aq i ashpër sa ai i publikut të gjerë. Por përgjigjet e tyre pasqyrojnë shqetësim edhe për atë segment të popullsisë që është i punësuar dhe relativisht i siguruar financiarisht.

- 40,1% e nëpunësve publikë besojnë se situata e përgjithshme ekonomike është “E keqe ose shumë e keqe” dhe vetëm 14,9 mendojnë se është “E mirë ose shumë e mirë”.
- 44% e tyre mendojnë se gjendja ekonomike është më keq se një vit më parë, gjë që është në të njëjtën linjë me ndjenjën e përgjithshme të përkeqësimit të të situatës ekonomike.


**Fig. 36 Situata e përgjithshme ekonomike në Shqipëri**

*Publiku i gjerë*



**Fig. 37 Situata e përgjithshme ekonomike e vendit krahasuar me një vit më parë**

*Publiku i gjerë*




Perceptimi se situata ekonomike po përkeqësohet, konfirmohet nga përgjigjet e njerëzve rreth gjendjes personale ekonomike. Një e treta (33%) e shqiptarëve thonë se gjendja e tyre ekonomike është më e keqe se një vit më parë, një rritje prej 19% nga sondazhi 2006 (Fig.38).

Qytetarët po bëhen më pesimistë në lidhje me të ardhmen ekonomike. Pothuajse 28% e publikut të gjerë mendojnë se situata ekonomike e vendit do të përkeqësohet vitin e ardhshëm (Fig.39), 16% më shumë se në sondazhin 2006.

**Fig. 38 Gjendja personale ekonomike krahasuar me një vit më parë**

*Publiku i gjerë*



**Fig. 39 Situata ekonomike e vendit pas një viti**

*Publiku i gjerë*

